



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 23 Shkurt 2017

Njoftim

Rritje e sasisë së shërbimeve shëndetësore në vitin 2017

Buxhet më i lartë për KU për kirurgji të fëmijëve

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë për vitin 2017 Klinikës universitare për kirurgji të fëmijëve i ka siguruar buxhet në vlerë prej 133 milion denarë, buxhet i cili është më i lartë se dyfishi i buxhetit të vitit 2012 kur ka qenë 65 milion denarë.

Investimi sistematik dhe i vazhdueshëm në shëndetin publik të Maqedonisë, i analizuar nga aspekti i DSG metodës, rezulton me rritje të indeksit casemix të operacioneve kirurgjikale. Në KU për kirurgji të fëmijëve në vitin 2016 janë operuar dhe hospitalizuar 1.870 pacient. Sipas indeksit casemix, ndërlíkueshmëria dhe vështirësia e këtyre operacioneve në vitin 2016 ka qenë 2,67 që dëshmon se është rritur pothuajse dyfish në krahasim me vitin 2012 kur ka qenë 1,65. Ky indeks përveç që dëshmon se është rritur numri i pacientëve të hospitalizuar, dëshmon se ekipet e mjekëve të kësaj klinike veprojnë dhe kryejnë intervenime kirurgjikale që ndër vite ndërlíkohen edhe më tepër.

Rritja e buxhetit të kësaj klinike është arsye e operacioneve kirurgjikale të fëmijëve dhe transplantit të veshkave të fëmijëve, shërbime që viteve të fundit kryehen nga mjekët tonë. Respektivisht përveç kardiokirurgjisë, në Klinikë kryhen edhe transplantime të veshkave të fëmijëve. Fondi siguron buxhet kushtëzues në vlerë prej 2 milion denarëve për tre transplante të veshkave në nivel vjetor.

Në bazë të të dhënave reale, në vitin 2013 janë kryer 30 operacione kardiovaskulare, në vitin 2016 janë kryer 52 operacione kardiovaskulare, ndërsa në vitin 2017 planifikohet të kryhen 60 operacione kardiovaskulare të fëmijëve. Theksojmë se numri më i madh i këtyre rasteve ju referohet foshnjave të posalindura.

Kryerja e operacioneve të ndërlíkkuara bashkëkohore në Maqedoni, është rezultat i përfitimeve të shumfishta si për institucionet publike ashtu edhe për shëndetësinë në përgjithësi.

Buxheti i kushtëzuar për KU për kirurgji të fëmijëve ka për qëllim t'a stimulojë rritjen e shërbimeve shëndetësore deficitare, të shfrytëzohet për shërbimet e reja shëndetësore dhe për metodat bashkëkohore për mjekim.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Viti	Buxheti i kushtëzuar ndër vite
2011	63.175.431
2012	65.000.000
2013	71.000.301
2014	111.824.145
2015	120.000.000
2016	123.900.000
2017	132.900.000

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë vazhdon të jetë konsekuent në zbatimin e të gjitha aktiviteteve dhe masave për të siguruar në kohë shërbimet shëndetësore kualitative të cilat janë të domosdoshme për të siguruarit.